LIGJ
Nr.10 373, datë 10.2.2011

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR. 7767, DATË 9.11.1993 "PËR ADERIMIN NË KONVENTËN "PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 12 pika 1 shkronja "b" të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7767, datë 9.11.1993 "Për aderimin në konventën "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave"", shtohet neni 2 me këtë përmbajtje:

"Neni 2

Pranimin nga Republika e Shqipërisë të ndryshimit të nenit 20 paragrafi 1 të konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave", i cili përcakton se Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (Komiteti CEDAW) duhet të mblidhet normalisht çdo vit, me qëllim shqyrtimin e raporteve të paraqitura në përputhje me nenin 18 të kësaj konvente.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6901, datë 22.2.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Kombet e Bashkuara
A/RES/49/164

Asambleja e Përgjithshme
Shpërndarja: E përgjithshme
Datë: 23 dhjetor 1994

Origjinali: Anglisht

Sesioni i dyzetenëntë
Pika 97 e rendit të ditës

REZOLUTA TË MIRATUARA NGA ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

49/164. Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave

Asambleja e Përgjithshme,

duke pasur parasysh se një nga qëllimet e Kombeve të Bashkuara, të shprehura në nenet 1 dhe 55 të Kartës, është të nxisë respektimin universal të të drejtave të njeriut dhe të drejtave themelore për të gjithë pa asnjë lloj dallimi, duke përfshirë dallimin gjinor;

duke konfirmuar se gratë dhe burrat duhet të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në zhvillimin social, ekonomik dhe politik, të kontribuojnë në mënyrë të barabartë për një zhvillim të tillë dhe të ndajnë në mënyrë të barabartë kushtet e përmirësuara të jetesës;

duke iu referuar rezolutës së saj 34/180 të datës 18 dhjetor 1979, me anë të së cilës miratoi Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave;

duke iu referuar edhe rezolutave të saj të mëparshme për Konventën, dhe duke parë rezolutën 1994/7 të Këshillit Ekonomik dhe Social të datës 21 korrik 1994;

duke mirëpritur numrin në rritje të shteteve palë në Konventë, që tashmë janë njëqind e tridhjetë e katër;

duke vërejtur me shqetësim të thellë se Konventa është ende një ndër instrumentet e të drejtave të njeriut me një numër të madh rezervash, shumë prej të cilave bien ndesh me objektin dhe qëllimin e Konventës, pavarësisht faktit se disa prej shteteve i kanë tërhequr rezervat e tyre ndaj saj;

duke iu referuar Deklaratës së Vjenës dhe programit të veprimit, të miratuara nga Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut të datës 25 qershor 1993, ku Konferenca parashikoi që të drejtat e grave dhe të vajzave ishin pjesë e patjetërsueshme, integrale dhe e pandarë e të drejtave universale të njeriut;

duke iu referuar gjithashtu faktit se në Deklaratën e Vjenës dhe në programin e veprimit, konferenca rekomandoi miratimin e procedurave të reja për forcimin e zbatimit të angazhimit për barazinë e grave dhe për të drejtat e njeriut, duke përfshirë thirrjen ndaj Komisionit për Statusin e Grave dhe Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave për të shqyrtuar me shpejtësi mundësinë e prezantimit të së drejtës së peticionit, nëpërmjet përgatitjes së një protokolli alternativ ndaj Konventës;

duke parë vendimin e miratuar në takimin e gjashtë të shteteve palë në Konventë më 4 shkurt 1992;

të ndërgjegjshëm për rëndësinë e kontributit që zbatimi i strategjive largpamëse të Najrobit për avancimin e grave mund të sjellë eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe arritjen e barazisë ligjore dhe faktike ndërmjet grave dhe burrave;

pasi janë shqyrtuar raportet e Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave në sesionet e tij të dymbëdhjetë dhe të trembëdhjetë;

duke parë sugjerimet dhe rekomandimet e përgjithshme të bëra nga Komiteti në përputhje me mandatin e tij, siç është demonstruar së fundi nga Komiteti në sesionin e tij të trembëdhjetë, në të cilin Komiteti miratoi sugjerimin nr.6 në Konferencën Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe rekomandimin e përgjithshëm nr.21 në lidhje me nenet 9, 15 dhe 16 të Konventës si kontribut për Vitin Ndërkombëtar për Familjen, si dhe rekomandime të tjera të përgjithshme të bëra nga Komiteti;

duke parë se ngarkesa e punës së Komitetit është rritur si rrjedhojë e rritjes së numrit të shteteve palë në Konventë, se sesioni vjetor i Komitetit është ende më i shkurtri i të gjitha sesioneve vjetore të organeve të traktateve të të drejtave të njeriut dhe se përveç rekomandimeve të Këshillit Ekonomik dhe Social në rezolutën e tij 1992/17 të datës 30 korrik 1992, që u mbështet nga Asambleja e Përgjithshme në rezolutën e saj 47/94 të datës 16 dhjetor 1992, dhe se do të mundësoheshin tri javë për çdo sesion të Komitetit për të shqyrtuar raportet e dorëzuara nga shtetet palë derisa të jenë

eliminuar raportet e prapambetura, ende mbetet punë për t'u bërë;

të bindur për nevojën për të miratuar masa për t'i mundësuar Komitetit që të shqyrtojë në mënyrë të hollësishme dhe në kohë raportet e dorëzuara nga shtetet palë dhe të përmbushë të gjitha përgjegjësitë e tij sipas Konventës;

duke parë raportin e Sekretarit të Përgjithshëm mbi metodat e punës të Komitetit dhe të kapacitetit të tij për të realizuar mandatin e tij në mënyrë efikase, gjë e cila përfshinte një krahasim të organeve të tjera të traktateve;

duke mirëpritur përpjekjet e Komitetit për të përmirësuar më tej metodat e punës, duke miratuar vëzhgimet përfundimtare që përmbanin sugjerime dhe rekomandime specifike;

duke iu referuar faktit se, sipas nenit 17, paragrafi 9 i Konventës, Sekretarit të Përgjithshëm i kërkohet të sigurojë personelin dhe shërbimet e nevojshme për realizimin efikas të funksioneve të Komitetit;

duke iu referuar gjithashtu rezolutave të tij 44/73 të datës 8 dhjetor 1989, 45/124 të datës 14 dhjetor 1990 dhe 47/94 të datës 16 dhjetor 1992, ku ndër të tjera mbështeten fuqimisht pikëpamjet e Komitetit që Sekretari i Përgjithshëm duhet t'i japë më shumë prioritet forcimit të mbështetjes së Komitetit;

duke mbështetur fuqimisht rekomandimin e përgjithshëm nr.19 të Komitetit mbi dhunën ndaj grave dhe thirrjen drejtuar shteteve palë për të përgatitur raportet e tyre periodike në përputhje me këtë dhe me rekomandime të tjera të përgjithshme të Komitetit;

duke vërejtur me kënaqësi emërimin e një Raportuesi Special të Komisionit për të Drejtat e Njeriut mbi dhunën ndaj grave, duke përfshirë shkaqet dhe pasojat e saj:

1. Shpreh kënaqësinë e saj për rritjen e numrit të shteteve që kanë ratifikuar apo kanë aderuar në Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe mbështet rekomandimin e përgjithshëm të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave për të tërhequr vëmendjen ndaj atyre rezervave, të cilat janë të papajtueshme me objektivin dhe qëllimin e Konventës.

2. Nxit të gjitha shtetet që nuk kanë ratifikuar ende apo nuk kanë aderuar në Konventë që ta realizojnë këtë sa më shpejt që të jetë e mundur.

3. Thekson rëndësinë e respektimit tepër të rreptë nga ana e shteteve palë të detyrimeve të tyre sipas Konventës.

4. Nxit shtetet që të shqyrtojnë kufizimin e shkallës së çdo rezerve që ata vendosin ndaj Konventës, të formulojnë çdo rezervë sa më saktësisht dhe ngushtësisht që të jetë e mundur dhe të sigurojnë që asnjë rezervë nuk është e papajtueshme me objektin dhe qëllimin e Konventës ose që nuk është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.

5. I kërkon shteteve palë në Konventë që të shqyrtojnë rezervat e tyre në mënyrë të rregullt, me synimin e tërheqjes së tyre me shpejtësi, në mënyrë që Konventa të mund të zbatohet plotësisht.

6. Merr parasysh raportin e Sekretarit të Përgjithshëm për statusin e Konventës dhe i kërkon atij të vazhdojë të raportojë çdo vit pranë Asamblesë së Përgjithshme.

7. Merr parasysh gjithashtu raportet e Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave në sesionet e tij të dymbëdhjetë dhe të trembëdhjetë.

8. Rekomandon që shtetet palë në Konventë, duke marrë parasysh raportet e përmendura në paragrafët 6 dhe 7 më sipër, të shqyrtojnë situatën punuese të Komitetit dhe të kapacitetit të tij për të përmbushur mandatin e tij në mënyrë më efikase, dhe në këtë kontekst rekomandon gjithashtu që shtetet palë të shqyrtojnë mundësinë e ndryshimit të nenit 20 të Konventës, me qëllim që të lejohet kohë e mjaftueshme mbledhjesh për Komitetin.

9. I kërkon shteteve palë në Konventë që të takohen në vitin 1995 për të shqyrtuar rishikimin e nenit 20 të Konventës së përmendur në paragrafin 8 më sipër.

10. Fton shtetet palë në Konventë që të bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme për të dorëzuar raportin e tyre të parë, të dytë dhe raportet vijuese periodike për zbatimin e Konventës, në përputhje me nenin 18 dhe me udhëzimet e siguruara nga Komiteti, dhe të bashkëpunojnë plotësisht me Komitetin në paraqitjen e raporteve të tyre.

11. Mirëpret përpjekjet e bëra nga Komiteti për të racionalizuar procedurat e tij dhe për të përshpejtuar shqyrtimin e raporteve periodike dhe inkurajon fuqimisht Komitetin të vazhdojë këto përpjekje.

12. Mirëpret gjithashtu, në përputhje me rekomandimin nr.11 të Komitetit, iniciativat e ndërmarra për të siguruar kurse rajonale trajnimi për përgatitjen dhe hartimin e raporteve të shteteve palë për zyrtarët qeveritarë dhe trajnime dhe seminare informuese për shtetet që shqyrtojnë aderimin në Konventë dhe nxit organet dhe organizatat përkatëse të Kombeve të Bashkuara që të mbështesin iniciativa të tilla.

13. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm të vazhdojë përpjekjet e tij për të siguruar personelin e Sekretariatit, duke përfshirë anëtarë të personelit ligjor që janë ekspertë në zbatimin e traktateve për të drejtat e njeriut dhe burimet teknike, në mënyrë që Komiteti të realizojë me efikasitet funksionet e tij.

14. Mbështet fuqimisht pikëpamjen e Komitetit se Sekretari i Përgjithshëm duhet t'i japë më shumë prioritet, brenda burimeve ekzistuese, forcimit të mbështetjes teknike dhe materiale për Komitetin, në mënyrë të veçantë për të ndihmuar në studimin përgatitor.

15. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm të vazhdojë të sigurojë, të lehtësojë dhe të nxisë, brenda burimeve ekzistuese, shpërndarjen e informacionit në lidhje me Komitetin, vendimet dhe rekomandimet e tij, me Konventën dhe konceptin e njohurive ligjore, duke marrë parasysh rekomandimet e vetë Komitetit për këtë qëllim.

16. Mbështet kërkesat e Komitetit dhe të sesionit të dymbëdhjetë e të trembëdhjetë të tij për kohë shtesë për mbledhjet, me mbështetje të mjaftueshme nga Sekretariati, me qëllim që të mundësohet që Komiteti të mblidhet njëherë në vit për tri javë për sesionet e tij katërmbëdhjetë e të pesëmbëdhjetë, dhe rekomandon që kërkesa e bërë nga Komiteti për kohë shtesë për mbledhjet të shqyrtohet brenda nivelit ekzistues të burimeve buxhetore.

17. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm të sigurojë mbështetje të mjaftueshme për Komitetin dhe gjithashtu të kërkojë që të sigurohen burime shtesë për këtë qëllim nga brenda buxhetit të rregullt ekzistues për të bërë të mundur që Komiteti të trajtojë në mënyrë të imtësishme dhe në kohë raportet që dorëzohen nga shtetet palë.

18. Vendos që në sesionin e tij të pesëdhjetëenjëtë, ai do të shqyrtojë përsëri nëse puna e pakryer e Komitetit në lidhje me shqyrtimin e raporteve është reduktuar apo jo.

19. Rekomandon që mbledhjet e Komitetit të programohen, kurdo që është e mundur, që të lejojnë një transmetim në kohë të rezultateve të punës së tij pranë Komisionit për Statusin e Grave, për informacion në të njëjtin vit.

20. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm të dorëzojë pranë Asamblesë së Përgjithshme në sesionin e pesëdhjetëenjëtë, një raport mbi zbatimin e rezolutës së tanishme dhe t'i vërë një raport në dispozicion Komisionit për Statusin e Grave në sesionin e tij të dyzetenjëtë.

Mbledhja plenare e 94-t
23 dhjetor 1994

Kombet e Bashkuara A/RRES/50/202
Asambleja e Përgjithshme Shpërndarja: E përgjithshme
23 shkurt 1996

Sesioni i pesëmbëdhjetë
Pika 165 e rendit të ditës

REZOLUTË E MIRATUAR NGA ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Mbi Raportin e Komitetit të Tretë(A/50/816)

50/202. Ndryshimi i nenit 20, paragrafi 1 i Konventës për eliminimin e të gjitha formave të

diskriminimit ndaj grave

Asambleja e Përgjithshme,

duke iu referuar rezolutës së saj 49/164 të datës 23 dhjetor 1994 mbi Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave[1] dhe vendimit të saj 49/448 të datës 23 dhjetor 1994 mbi shqyrtimin e kërkesës për rishikimin e nenit 20, paragrafi 1 i Konventës;

duke parë vendimin e shteteve palë në Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave të datës 22 maj 1995[2] për të ndryshuar nenin 20, paragrafi 1 të Konventës;

duke mirëpritur thirrjen për ratifikim të gjerë të këtij ndryshimi, në Platformën për Veprim të Konferencës së Katërt Botërore për Gratë[3], e mbajtur në Pekin nga data 4 deri më 15 shtator 1995;

duke ritheksuar rëndësinë e Konventës, si dhe kontributin e Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave për përpjekjet e Kombeve të Bashkuara për të eliminuar diskriminimin ndaj grave:

1. Miraton rezolutën në lidhje me ndryshimin e nenit 20, paragrafi 1 i Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, e miratuar nga shtetet palë të Konventës në datën 22 maj 1995;

2. Nxit shtetet palë të Konventës që të marrin masat e duhura, në mënyrë që të arrihet pranimi nga shtetet palë me shumicë prej dy të tretash sa më shpejt që të jetë e mundur, me qëllim që ndryshimi të hyjë në fuqi.

Mbledhja plenare e 99-të
22 dhjetor 1995

[1] Rezoluta 34/180, aneksi

[2] CEDAW/SP/1995/2, aneksi

[3] A/CONF.177/20 dhe shtojca 1, kapitulli 1, rezoluta 1, aneksi II. 96-76879